



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
POSTA SHQIPTARE SH.A
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
DREJTORIA LIGJORE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____.____.2023

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)

Datë 21.02.2023

Drejtuar: Operatori ekonomik “InfoSoft Office” SHPK, me NUIS J62426002Q;

Me adresë: Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, **Tiranë**.

Procedura e prokurimit: “Të hapur mbi kufirin e lartë monetar”

Numri i procedurës/referenca e Lotit: REF-52148-12-05-2022

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Blerje kancelari dhe zarfa”, me fond limit 40,577,848 (dyzet milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind e dyzet e tetë) pa TVSH.

Në Eur : 348,188.16 (treqind e dyzet e tetë mijë njëqind e tetëdhjetë e tetë pikë gjashtëmbëdhjetë) Euro, pa TVSH., malli do të dorëzohet për 90 (nëntëdhjetë) ditë kalendarik nga data e hyrjes në fuqi të kontratës.

Publikimet e mëparshme (nëse aplikohet): Buletini i Njoftimeve Publike datë 12.12.2022, nr. 170

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X

Me anë të kësaj, ju informojmë se Ofertuesit e mëposhtëm kanë marrë pjesë në këtë procedurë me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “IT Gjergji Kompjuter” sh.p.k me NIPT K81503063B me vlerë të ofertës ekonomike **27,197,592.50** (njëzet e shtatë milion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e dy pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “Librari Dyrrahu” sh.p.k me NIPT L91418502J me vlerë të ofertës ekonomike **35,555,000** (tridhjetë e pesë milion e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH;
3. Operatori Ekonomik “Office Center” sh.p.k me NIPT K41425042N me vlerë të ofertës ekonomike **33,590,250** (tridhjetë e tre milion e pesëqind e nëntëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH;

4. Operatori ekonomik “**InfoSoft Office**” sh.p.k me NIPT J62426002Q me vlerë të ofertës ekonomike **39,187,981** (tridhjetë e nëntë milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një)lekë pa TVSH.

5. Operatori Ekonomik “**Interlogistic**” sh.p.k me NIPT K21605003M me vlerë të ofertës ekonomike **39,984,650** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH;

6. Operatori ekonomik “**Dynamix Group**” sh.p.k., me NIPT L42306022T nuk ka paraqitur ofertë ekonomike;

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “**IT Gjergji Kompjuter**” SHPK, u konstatua se:

Nga vlerësimi i dokumentave të paraqitura nga OE “**IT Gjergji Kompjuter**” SHPK sa i takon kritereve “Kapaciteti teknik” rezulton se për pikën Pika 22 *Vlerësimi i ofertave dhe korigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalish të ulëta...* 2. *Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalish e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni.*

Pas konstatimit të ofertës si anomalish të ulët sipas parashikimeve të Nenit 93 të LPP, KVO nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik i ka kërkuar në datë 30.01.2023 ora 09:44 OE “**IT Gjergji Kompjuter**” të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë. Në datë 01.02.2023, në Sistemin e Prokurimit Elektronik jemi njohur me përgjigjen e OE “**IT Gjergji Kompjuter**” i cili nuk jep asnjë shpjegim bindës apo asnjë analizë financiare sikurse e kërkon pika 4 e Nenit 82 e VKM Nr. 285, datë 19.05.2021”Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në të cilin citohet ndër të tjera se..... “*Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së*”.

Duke qenë se OE “**IT Gjergji Kompjuter**” nuk ka sjellë një përgjigje shteruese, aspak bindëse, pa prova shkresore dhe pa asnjë analizë financiare sa i takon ofertës ekonomike të paraqitur në këtë procedurë, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e konsideron sërish këtë ofertë ekonomike si anomalish të ulët dhe për këtë arsye ajo refuzohet.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “**Office Center**” SHPK, u konstatua se:

Nga vlerësimi i dokumentave të paraqitura nga OE “**Office Center**” SHPK sa i takon kritereve “Kapaciteti teknik” rezulton se për sa i takon shtojcës 7, pika 2. *Kriteret e Veçanta të Kualifikimit në të cilën është përcaktuar se 1. Ofertuesi duhet të paraqesë: a. Formularin Përmbledhës të Vetë deklaratimit, sipas shtojcës 8; b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;* kemi konstatuar se në Sistemin e Prokurimit Elektronik, OE “**Office Center**” SHPK nuk ka depozituar formularin e sigurimit të ofertës ekonomike.

Gjithashtu, nga vlerësimi i pikës 2.3.5 në të cilën kërkohet... *Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt 6, 10, 13, 17, 18, 28 36, 37, 38, 42 të kërkuar sipas listës së artikujve ne Shtojcën 5, Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim....* Nga vlerësimi i mostrave të paraqitura, konkretisht mostra për artikullin numër 28 “Zarf kartoni për shërbimin EMS 230x330mm nuk ishte sipas përcaktimit të kriterit në shtojcën numër 5 në të cilën janë përcaktuar si më poshtë:

*Për artikujt 28, 29 të cilët duhet të jenë me Logo të Shërbimit EMS, kjo e fundit duhet të jetë në formën dhe ngjyrën e përcaktuar me kodet dhe përmasat si më poshtë....EMS: **BËHET** Blu CMYK: (79,58, 0,38), Portokalli CMYK: (0,48,100,0) Në pjesën e përparme të hapjes së zarfit përmasat e logos EMS janë 18x2.5 cm. Në pjesën e pasme të zarfit përmasat e logos EMS janë 16.5x2.3 cm.*



OE “**Office Center**” SHPK ka paraqitur si mostër një zarf me ngjyrë të verdhë dhe me mbishkrimin DHL.

Mostrat e paraqitura nuk ishin në përputhje me kërkesat e DST.

3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “**Librari Dyrrahu**” SHPK, u konstatua se: Nga vlerësimi i dokumentave të paraqitura nga OE “**Librari Dyrrahu**” SHPK sa i takon kriterëve “Kapaciteti teknik” rezulton se për pikën 2.3.5 në të cilën kërkohet... *Operatori ekonomik duhet të paraqesë mostra për artikujt 6, 10, 13, 17, 18, 28 36, 37, 38, 42 të kërkuar sipas listës së artikujve ne Shtojcën 5, Mostrat duhet të paraqiten ditën dhe orën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Mosparaqitja e mostrave të kërkuara si dhe mospërputhja e tyre me specifikimet teknike është kusht për skualifikim....* nuk është paraqitur në orën dhe datën e përcaktuar për të dorëzuar mostrat për artikujt e kërkuar në shtojcën 5 të DST

4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga OE “**Dynamix Group**” SHPK, u konstatua se: OE “**Dynamix Group**” nuk ka paraqitur oferte ekonomike në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se Operatori ekonomik “**InfoSoft Office**” SHPK me NIPT J62426002Q me adresë: Kashar, Autostrada Tiranë-Durrës, Km 8, **Tiranë**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të totale prej **39,187,981** (tridhjetë e nëntë milion e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e një) lekë pa T.V.SH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë “Posta Shqiptare” SHA, Adresa: Rr, “Reshit Çollaku”, Nr. 4, Tiranë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **39,984,650** (tridhjetë e nëntë milion e nëntëqind e tetëdhjetë e katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*) - Nuk ka

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
Ardit Demiri